KEK KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a. KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C. ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

# Shpallje Publike

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të punës, Seksionin V, Pikën 3 (c) të Rregullores së KEK Sh.a dhe në bazë të skemës organizative të aprovuar të **Zyrës së Auditimit të Brendshëm**, si dhe nevojave për plotësimin e sajë me kuadër profesional, Divizioni i Burimeve Njerëzore, më datë: 02.02.2023 publikon vendet e lira për pozitat e mëposhtme:

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a. KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C. KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.
02-02-2023
Nr. 606
PRISHTINË

## Auditor Kryesor

(1 vend pune)

**Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:**

Bartësi i kësaj pozite do të ketë përgjegjësi: Te planifikoj, organizojë dhe të monitoroj kryerjen e auditimeve të rregullta të KEK-ut bazuar ne urdhëresat e punës te lëshuara nga Drejtori i Auditimit per AB, te ofroj një vlerësimi objektiv të divizioneve, fushave, departamenteve ose operacioneve funksionale.
Te vlerësoj përshtatshmërinë dhe efektivitetin e kontrolleve të hartuara për të menaxhuar rreziqet dhe për të siguruar se objektivat janë përmbushur.
Të përcaktojë nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me buxhetin e miratuar, me ligjet, me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.
Të vlerësojë ekspozimet ndaj rrezikut që kanë të bëjnë me qeverisjen, operacionet dhe sistemet e informacioneve të organizatës në lidhje me arritjen e objektivave strategjike të organizatës, besueshmërinë dhe integritetin e informacioneve financiare dhe operacionale, efektivitetin dhe efikasitetin e operacioneve dhe programeve, ruajtjen e pasurisë dhe të vepruarit në përputhje me ligjet, rregulloret dhe kontratat.
Verifikimi ne teren mbi kryerjen e punëve nga divizionet se a janë komfor rregulloreve, kontratave dhe ligjeve ne fuqi.
Identifikon mangësitë substanciale në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit të organizatës dhe ofron rekomandime për përmirësimin e tyre.

**Detyrat dhe Përgjegjësitë ;**Monitoron ekzekutimin e urdhëresave te punës për rastet e auditimit të lëshuara nga Drejtori i Zyrës së Auditimit. Auditori kryesore bënë rishikimin dhe certifikimin e nivelit të parë të draft-raporteve të përpiluar nga auditorët e lartë dhe e dërgon te drejtori i ZAB për certifikim final. Përgatit raportet periodike, mujore, tremujore, përmbledhë raportin e implementimit te rekomandimeve nga auditorët e brendshëm, dhe çdo raport tjetër qe i nevojitet ZAB.Ndihmon ZAB ne vlerësimin e performances se ZAB, hartimin e planit strategjik dhe vjetor te ZAB, përgatitjen e buxhetit për ZAB dhe rastet tjera kur kërkohet nga ZAB.Analizimi dhe verifikimi i fakteve dhe proceseve të mësipërme dhe analizimi i informatave paraprake dhe materialeve, paraqitja e tyre tek zyrtaret tek te cilët raporton për procese të mëtutjeshme dhe përfaqësimi i interesave të KEK-ut në lidhje me proceset e mëtutjeshme.Kryerja e kontrolleve të rastësishme në bazë të kërkesës së Drejtorit te Auditimit. Të kryejë një vlerësim të pavarur të efektshmërisë se politikave, procedurave dhe standardeve, ne baze te cilave Pasurit financiare, fizike dhe burimeve të informacionit te KEK-ut janë duke u menaxhuar. Auditimin e kostos së kompanisë për të siguruar që ato nuk përfshijnë shpenzimet të cilat janë të paarsyeshme, te panevojshme ose nuk janë në interes të kompanisë. Auditimin e investimeve kapitale për të siguruar që programet e ndërtimit kapital të KEK-ut janë të bazuara në investime ekonomike të kujdesshme dhe në përdorimin e dobishëm të aseteve. Ne koordinim me Drejtorin e Auditimit definon llojet dhe teknikat e auditimit të brendshëm që do të përdoret në çdo rast te auditimit, që vepron në bazë të legjislacionit, praktikave më të mira, dhe përvojës dhe njohurive profesionale. Monitorimin e përgjigjeve te menaxhmentit ne raportet finale, verifikimin e implementimit te zbatimin e rekomandimeve dhe raportimin e tyre.Tregon integritetin personal dhe profesional në përputhje me kompaninë misionin, vizionin dhe vlerat e saj.Është përgjegjës qe stafi te respektoj rregulloret e brendshme ne fuqi te korporatës, Eshte përgjegjës qe stafi te kenë angazhim dhe te jene te disiplinuar ne pune.Udhëheq, Monitoron dhe këshillon stafin e Auditimit te brendshëm gjate kryerjes se angazhimeve ditore, verifikon letrat e punës dhe i nënshkruan ato dhe ne baze te kërkesës i dërgon tek Drejtori i Auditimit për shqyrtim.Organizon dhe merr pjese ne takimet fillestare me te audituarit dhe takimet tjera gjate angazhimit te Auditimit.Kujdeset qe stafi i zyrës se Auditimit te brendshëm te jene ne hap me zhvillimet dhe ndryshimet ne fushën e Auditimit dhe ndryshimet ligjore qe kane te beje me ushtrimin e detyrës se auditorit, ku përpilon plan vjetor mbi edukimin e vazhdueshëm profesional dhe avancimin e tyre.Kryen detyra të tjera me kërkesë të Drejtorit të Auditimit te Brendshëm.**Autorizimet;**Varësisht nga fushëveprimi i auditimit me qëllim të përmbushjes së detyrave të punës, ka qasje të pakufizuar në të gjitha dokumentacionet dhe pasuritë e KEK-ut duke u bazuar ne ligjet ne fuqi te Auditimit te Brendshëm, rregulloret dhe statutet ne fuqi.Kryen inspektime, dhe ndërmerr veprime të tjera që janë të domosdoshme për përmbushjen e qëllimeve dhe detyrave të departamentit ne koordinim me Drejtorin e Auditimit.Merr shpjegime me gojë (intervista) apo me shkrim nga punonjësit e KEK me qëllim të përmbushjes së objektivave të auditimit.

**Kërkesat profesionale/ Kualifikimet**

- Diplomë Universitare e fakultetit: Ekonomik, Juridikut, Inxhinierisë. Kërkohet qe kandidatët të kanë minimum 240 kredi (ECTS).
- Certifikatë të auditorit të brendshëm siç e parasheh LIGJI Nr. 06/L-021
- Së paku 3 vite përvojë pune në auditim të brendshëm.

**Shkathtësitë tjera;**Njohuri të thellë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe praktikave më të mira të Auditimit.Aftësi profesionale dhe kujdes të duhur profesional gjatë ushtrimit të detyrës.I pavarur dhe objektiv gjatë kryerjes së punës dhe të ketë aftësi të larta analitike.Njohuri të rregullativës ligjore në përgjithësi dhe me theks të veçantë të rregullativës ligjore aktuale të KEK-ut..Njohuri në lëminë e energjetikës, financa, kontabilitet, legjislacion dhe teknologjisë së informacionit. Njohuri rreth funksionimit të ndërmarrjeve publike si dhe industrisë së prodhimit.Njohja e gjuhës angleze, e preferuar.Aftësi profesionale në komunikim dhe në të shkruar.Aftësi për të punuar në grupe (të din të udhëheqë dhe të jetë i udhëhequr nga të tjerët).

## Auditor i Lartë Financiar

(1 vend pune)

**Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:**

Të vlerësojë nëse veprimtaritë e organizatës janë në pajtim me ligjet, aktet nënligjore, aktet e brendshme dhe rregulloret në fuqi.Të përcaktojë nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me buxhetin e miratuar, me ligjet, me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik. Të vlerësojë ekspozimet ndaj rrezikut që kanë të bëjnë me qeverisjen, operacionet dhe sistemet e informacioneve të organizatës në lidhje me arritjen e objektivave strategjike të anizatës, besueshmërinë dhe integritetin e informacioneve financiare dhe operacionale, efektivitetin dhe efikasitetin e operacioneve dhe programeve, ruajtjen e pasurisë dhe të vepruarit në përputhje me ligjet, rregulloret dhe kontratat.
Të vlerësojë mundësinë e ndodhjes së mashtrimit dhe mënyrën se si organizata menaxhon rrezikun e mashtrimit.
Identifikon mangësitë substanciale në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit të organizatës dhe ofron rekomandime për përmirësimin e tyre.
Vlerëson procedurat financiare dhe operative për përshtatshmërinë e kontrollit të brendshëm dhe ofron këshilla dhe udhëzime në aspektin e kontrollit për politika të reja, sisteme, procese dhe procedura.

Të ofroj sigurinë e arsyeshme që informacionet financiare dhe operative janë të besueshme dhe me integritet, që veprimtaritë (operacionet) janë kryer në mënyrë efikase dhe me synimin e arritjes së objektivave të vendosura, që pasuritë janë mbrojtur si duhet, dhe veprimet dhe vendimet e organizatës janë në përputhje me ligjet, rregulloret dhe kontratat ne fuqi.
Ofron rekomandime për përmirësimin dhe ngritjen e ekonomizimit, efikasitetit dhe efektivitetit të veprimtarive të organizatës.

**Detyrat dhe Përgjegjësitë** Zbaton urdhëresat e punës për rastet e auditimit të lëshuara nga Drejtori i Zyrës së Auditimit.Të zhvilloj dhe të dokumentoj një plan për secilin angazhim (angazhim në rastin e auditimit) duke përfshirë objektivat, objektin, kohën dhe shpërndarjen e burimeve të angazhimit. Të planifikoj dhe kryej angazhimin duke pasur mbikëqyrjen dhe miratimin e duhur.Të përgatis programin e angazhimit, identifikon kërkesat teknike, objektivat, rreziqet, proceset dhe transaksionet që duhet të shqyrtohen, parashtron natyrën dhe objektin e testimeve të nevojshme.Sigurimi i të dhënave dhe analiza e tyre për të mbështetur një opinion objektiv mbi saktësinë dhe rregullsinë e pasqyrave financiare. Kryerja efektive e aktiviteteve audituese për të bërë vlerësimin e rrezikut të menaxhimit dhe kontrolleve te brendshme.Gjykimi profesional lidhur me përcaktimin e efektivitetit të operimeve, përputhshmërinë e kontrollove, mjaftueshmërinë e evidencave dhe materialitetin e konstatimeve për të mbështetur opinionin dhe konkluzionet e prezantuara në raportet e auditimit.Bartësi i punës kryen auditime të kontrolleve të brendshme, te politikave dhe procedurave te kontabilitetit, te shënimeve te kontabilitetit dhe pasqyrave financiare të kompanisë. Përmes auditimeve verifikon se taksat dhe të dhënat financiare mbahen në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe ligjet ne fuqi te Republikës se Kosovës. Rregullisht rishikon politikat dhe procedurat e kontabilitetit të KEK-ut për të siguruar që të gjitha transaksionet e biznesit janë të regjistruar dhe raportuar në përputhje me kërkesat e IFRS. Auditimin e cilësisë se automatizuar te sistemeve informative të kontabilitetit dhe sistemeve tjera qe posedon Ndërmarrja për të siguruar se këto sisteme japin siguri te mjaftueshme për operim te sigurt te Ndërmarrjes. Përgatit letrat e punës për secilin angazhim (auditim) të cilat prezantohen tek udhëheqësi si mbikëqyrës. Prezantimi i konkluzioneve dhe rekomandimeve tek Udhëheqësi i Departamentit të Auditimit dhe Drejtori i Auditimit që përfshin rekomandimet dhe veprimet qe duhet te ndërmerr menaxhmenti për përmirësim te procesit te punës. Përpilon draft raporte të auditimit sipas standardeve të auditimit të brendshëm të cilat i dërgon për shqyrtim tek Auditori Kryesor dhe tutje për miratim tek Drejtori i Auditimit të Brendshëm përmes Auditorit Kryesor.Monitorimi i zbatimit te rekomandimeve qe janë dhënë gjate Auditimit dhe raportimi tek udhëheqësi i tij. Kryerja e kontrolleve të rastit dhe hetimeve të ndryshme në bazë të kërkesës së Auditorit kryesor apo te Drejtorit te Auditimit. Hartimi i raporteve finale lidhur me auditimet e kryera.Diskutimi i mangësive me menaxhmentin dhe rekomandimi i veprimeve për përmirësimin e kontrolleve interne, rritjen e eficiencës, zvogëlimin e shpenzimeve etj. Kryerja e rishikimeve post - audituese për të konstatuar implementimin e rekomandimeve të dhëna nga auditori.Freskimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale me ndryshimet në auditim, kontabilitet, ligje shtetërore etj. në mënyrë që auditimet të kryhen në pajtim me kërkesat profesionale.Kryen punën e tij me ndershmëri, kujdes dhe përgjegjësi duke respektuar kodin etik dhe rregulloret tjera te brendshme.Respekton ligjin dhe jep informacione shpjeguese ashtu siç pritet sipas ligjit dhe profesionit. Kryen detyra të tjera me kërkesë të Auditorit kryesor apo te Drejtorit të Auditimit te Brendshëm.

**Autorizimet:** Varësisht nga fushëveprimi i auditimit me qëllim të përmbushjes së detyrave të punës, ka qasje të pakufizuar në të gjitha dokumentacionet dhe pasuritë e KEK-ut duke u bazuar ne ligjet ne fuqi te Auditimit te Brendshëm, dhe rregulloret dhe statutet ne fuqi.Kryen inspektime, hetime të caktuara dhe ndërmerr veprime të tjera që janë të domosdoshme për përmbushjen e qëllimeve dhe detyrave të departamentit ne koordinim me Auditorin kryesor apo Drejtorin e Auditimit.Merr shpjegime me gojë (intervista) apo me shkrim nga punonjësit e KEK me qëllim të përmbushjes së objektivave të auditimit.

**Kërkesat profesionale/ Kualifikimet:**

- Diplomë Universitare në: Ekonomi, Financa Publike apo Kontabilitet.
- Certifikatë të auditorit të brendshëm siç e parasheh LIGJI Nr. 06/L-021
- Të jetë minimumi teknik i kontabilitetit
- Së paku 3 vite përvoje pune fushat relevante.

**Shkathtësitë tjera:**Njohuri të thellë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe praktikave më të mira të Auditimit.Aftësi profesionale dhe kujdes të duhur profesional gjatë ushtrimit të detyrës.I pavarur dhe objektiv gjatë kryerjes së punës dhe të ketë aftësi të larta analitike.Njohuri të rregullativës ligjore në përgjithësi dhe me theks të veçantë të rregullativës ligjore aktuale të KEK-ut.Njohuri në financa, kontabilitet dhe parime të kontrollit të kostos (ndonjë trajnim adekuat për kontabilitet dhe shpenzime).Njohuri rreth funksionimit të ndërmarrjeve publike si dhe industrisë së prodhimit.Njohja e gjuhës angleze, e preferuar.Aftësi profesionale në komunikim dhe në të shkruar.Aftësi për të punuar në grupe (të din të udhëheqë dhe të jetë i udhëhequr nga të tjerët).

## Auditor Junior i Përputhshmërisë

(1 vend pune)

**Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:**

Analizimin e të gjitha rreziqeve ne KEK dhe rregullisht verifikon përshtatshmërinë dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme të KEK-ut. Ofrimin e rekomandimeve specifike për ndryshime dhe përmirësime të kontrolleve të brendshme për të zbutur riskun e regjistrimit te gabuar dhe raportimin e transaksioneve të biznesit, humbjet ose shkatërrimin i pasurive, shpenzimet e tepërta, mashtrimet e kontabilitetit dhe vendim-marrjet e gabuara.
Te auditoj dhe te vlerësojë ekspozimet ndaj rrezikut që kanë të bëjnë me qeverisjen, operacionet dhe sistemet e informacioneve të organizatës në lidhje me arritjen e objektivave strategjike të organizatës, besueshmërinë dhe integritetin e informacioneve financiare dhe operacionale, efektivitetin dhe efikasitetin e operacioneve dhe programeve, ruajtjen e pasurisë dhe të vepruarit në përputhje me ligjet, rregulloret dhe kontratat.
Të vlerësojë mundësinë e ndodhjes së mashtrimit dhe mënyrën se si organizata menaxhon rrezikun e mashtrimit.
Auditimin e rregulloreve, rrjedhën e dokumenteve te kompanisë, dhe paraqitjen e sistemit për të siguruar se janë ne pajtim me praktikat më të mira të industrisë dhe për të përmbushur të gjitha kërkesat financiare dhe juridike të raportimit.
Të kryejë pune te terrenit se bashku me auditorët, qëllimi i te cilave është identifikimi i faktorëve te cilët kane ndikuar ne mos kryerjen e punëve apo ngecjen e tyre. Analizimi i këtyre faktorëve ne detaje dhe propozimi për përmirësim te procesit te punës.Auditimin e menaxhimit te kostos te kompanisë për të siguruar që ato nuk përfshijnë shpenzimet të cilat janë të paarsyeshme, te panevojshme ose nuk janë në interes të kompanisë. Auditimin e nvestimeve kapitale për të siguruar që programet e ndërtimit kapital të KEK-ut janë të bazuara në investime ekonomike të kujdesshme dhe në përdorimin e dobishëm të aseteve.
Auditimi i rregullsisë dhe përputhshmërisë me Rregulloret, Politikat e Brendshme dhe legjislacionit aktual.
Monitorimin e përgjigjeve te menaxhmentit dhe zbatimin e rekomandimeve qe janë dhëne gjate auditimeve.
I raporton dhe i jep përgjegjësi udhëheqësit te ekipit, ne raste specifike raporton dhe jep përgjegjësi Auditorit kryesor apo Zyrtarit i Auditmit te Brendshëm
Ofron ndihmë dhe mbështetje për ZAB ne KEK. Kryen detyra administrative dhe të zyrës për të ndihmuar në mbarëvajtjen e zyrës së ZAB

**Kërkesat profesionale/ Kualifikimet**

- Përgatitje Universitare ne drejtimet: Juridik, Ekonomik
- Duhet te këtë përvojë pune 2 vjeçare ne fushat relevante

## Auditor Junior Operativ

(1 vend pune)

**Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:**

Analizimin e të gjitha rreziqeve ne KEK dhe rregullisht verifikon përshtatshmërinë dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme të KEK-ut.
Te auditoj dhe te vlerësojë ekspozimet ndaj rrezikut që kanë të bëjnë me qeverisjen, operacionet dhe sistemet e informacioneve të organizatës në lidhje me arritjen e objektivave strategjike të organizatës, besueshmërinë dhe integritetin e informacioneve financiare dhe operacionale, efektivitetin dhe efikasitetin e operacioneve dhe programeve, ruajtjen e pasurisë dhe të vepruarit në përputhje me ligjet, rregulloret dhe kontratat.
Të vlerësojë mundësinë e ndodhjes së mashtrimit dhe mënyrën se si organizata menaxhon rrezikun e mashtrimit.
Auditimin e rregulloreve, rrjedhën e dokumenteve te kompanisë, dhe paraqitjen e sistemit për të siguruar se janë ne pajtim me praktikat më të mira të industrisë dhe për të përmbushur të gjitha kërkesat financiare dhe juridike të raportimit.
Të kryejë pune te terrenit se bashku me auditorët, qëllimi i te cilave është identifikimi i faktorëve te cilët kane ndikuar ne mos kryerjen e punëve apo ngecjen e tyre. Analizimi i këtyre faktorëve ne detaje dhe propozimi për përmirësim te procesit te punës.
Auditimin e menaxhimit te kostos te kompanisë për të siguruar që ato nuk përfshijnë shpenzimet të cilat janë të paarsyeshme, te panevojshme ose nuk janë në interes të kompanisë. Auditimin e investimeve kapitale për të siguruar që programet e ndërtimit kapital të KEK-ut janë të bazuara në investime ekonomike të kujdesshme dhe në përdorimin e dobishëm të aseteve.
Auditimi i rregullsisë dhe përputhshmërisë me Rregulloret, Politikat e Brendshme dhe legjislacionit aktual.
Monitorimin e përgjigjeve te menaxhmentit dhe zbatimin e rekomandimeve qe janë dhëne gjate auditimeve.
I raporton dhe i jep përgjegjësi udhëheqësit te ekipit, ne raste specifike raporton dhe jep përgjegjësi Auditorit kryesor apo Zyrtarit i Auditmit te Brendshëm.Ofron ndihmë dhe mbështetje për ZAB ne KEK. Kryen detyra administrative dhe të zyrës për të ndihmuar në mbarëvajtjen e zyrës së ZAB

**Kërkesat profesionale/ Kualifikimet**

- Përgatitje Universitare ne drejtimet: Juridik, Ekonomik, Inxhinierisë
- Duhet te këtë përvojë pune 2 vjeçare ne fushat relevante

## Auditor Junior Financiar
(1 vend pune)

**Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:**

Analizimin e të gjitha rreziqeve ne KEK dhe rregullisht verifikon përshtatshmërinë dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme të KEK-ut.
Te auditoj dhe te vlerësojë ekspozimet ndaj rrezikut që kanë të bëjnë me qeverisjen, operacionet dhe sistemet e informacioneve të organizatës në lidhje me arritjen e objektivave strategjike të organizatës, besueshmërinë dhe integritetin e informacioneve financiare dhe operacionale, efektivitetin dhe efikasitetin e operacioneve dhe programeve, ruajtjen e pasurisë dhe të vepruarit në përputhje me ligjet, rregulloret dhe kontratat.
Të vlerësojë mundësinë e ndodhjes së mashtrimit dhe mënyrën se si organizata menaxhon rrezikun e mashtrimit.
Auditimin e rregulloreve, rrjedhën e dokumenteve te kompanisë, dhe paraqitjen e sistemit për të siguruar se janë ne pajtim me praktikat më të mira të industrisë dhe për të përmbushur të gjitha kërkesat financiare dhe juridike të raportimit.Të kryejë pune te terrenit se bashku me auditorët, qëllimi i te cilave është identifikimi i faktorëve te cilët kane ndikuar ne mos kryerjen e punëve apo ngecjen e tyre. Analizimi i këtyre faktorëve ne detaje dhe propozimi për përmirësim te procesit te punës.Auditimin e menaxhimit te kostos te kompanisë për të siguruar që ato nuk përfshijnë shpenzimet të cilat janë të paarsyeshme, te panevojshme ose nuk janë në interes të kompanisë. Auditimin e investimeve kapitale për të siguruar që programet e ndërtimit kapital të KEK-ut janë të bazuara në investime ekonomike të kujdesshme dhe në përdorimin e dobishëm të aseteve.Auditimi i rregullsisë dhe përputhshmërisë me Rregulloret, Politikat e Brendshme dhe legjislacionit aktual.Monitorimin e përgjigjeve te menaxhmentit dhe zbatimin e rekomandimeve qe janë dhëne gjate auditimeve.I raporton dhe i jep përgjegjësi udhëheqësit te ekipit, ne raste specifike raporton dhe jep përgjegjësi Auditorit kryesor apo Zyrtarit i Auditmit te Brendshëm.Ofron ndihmë dhe mbështetje për ZAB ne KEK. Kryen detyra administrative dhe të zyrës për të ndihmuar në mbarëvajtjen e zyrës së ZAB

**Kërkesat profesionale/ Kualifikimet**

- Përgatitje Universitare ne drejtimet: Ekonomik, Administrim biznesi
- Duhet te këtë përvojë pune 2 vjeçare ne fushat relevante

**Divizioni i Burimeve Njerëzore, fton të gjithë të interesuarit të aplikojnë për pozitat e publikuara**

*Për hollësitë e mëtutjeshme për pozitat e lartpërmendura shikoni në faqen e internetit të KEK-ut:www.kek-energy.com pastaj shkoni tek ikona Shpallje dhe mund ta shkarkoni aplikacionin për pozitën që dëshironi të aplikoni. Aplikacioni i plotësuar bashkë me të dhënat tjera dërgohet përmes aplikimit online në linkun për pozitën përkatëse. Te gjithë aplikuesit, se bashku me aplikacionin, obligohen te dorëzojnë një **letër motivuese dhe dëshmitë për Kërkesat profesionale te kërkuara/ Kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara**.*

Vërejtje: Gjatë aplikimit duhet pasur kujdes që aplikacioni të jetë i kompletuar meqë për një pozitë pune mund të aplikohet vetëm një herë dhe për çdo dokument te kërkuar duhet te sillet dëshmia kur ju aplikoni ( dëshminë mund ta sillni edhe përmes emalit bashkë me aplikacion) Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të pranohen ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen. Kontrata e punës për të punësuarin për pozitën e zgjedhur do të jetë 1 vjeçare me mundësi vazhdimi ndërsa puna provues (6) muaj.

**Prishtinë, 20.02.2023**
**Data e aplikimit deri më**

**Divizioni i Burimeve Njerëzore**

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A. KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C. KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA D.D. KEK PRISHTINË-A